

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
SENATI AKADEMIK

Nr. 3434/Prot.
2

Tiranë, më 17.11.2023

VENDIM

Nr. 114, datë 17.11.2023

**“PËR CAKTIMIN E DITËS SË HËNË, DATË 27.11.2023, DITË PUSHIMI PËR
PROCESIN Akademik/MËSIMOR DHE ADMINISTRATIV NË UNIVERSITETIN E
MJEKËSISË, TIRANË”**

Bazuar në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, nenet 3, 38; Statutin e UMT-së, nenet 5 dhe 26;, si dhe duke mbajtur në konsideratë festat zyrtare të 28 dhe 29 Nëntorit, të cilat përkojnë ditën e martë dhe të mërkurë dhe me qëllim dhënien e mundësisë së studentëve që jetojnë në qytetet e tjera të Shqipërisë të vijojnë pushimet e tyre pandërprerje, Senati Akademik i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, pasi diskutoi mbi këtë propozim,

VENDOSI:

1. Dita e hënë, datë 27.11.2023, të caktohet ditë pushimi për procesin akademik/mësimor dhe atë administrativ në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë.
2. Zëvendësimin e kësaj dite në një ditë tjetër, e cila do të caktohet në një moment të dytë.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi njësitë kryesore dhe Rektorati i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

